

AKT THEMELIMI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ EnRel Hydro” SHPK

Sot ne daten 11.03.2013 qytetin e Korces ne baze te ligjit 9901 date 14.04 2008 “ Neni 230 pika 2 , Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare Ortaku:

- Aurel Naumi, biri i Andonit , datlindja 10.10.1964 shtetas Shqiptar, banues ne Korce posedues i Kartes se Identitetit Nr 031266514, madhor i afte per te kryer veprime juridike.

NENI 1

Shoqeria Tregetare do te mbaje emrin “EnRel Hydro” SHPK i cili do te jete i stamposur dhe ne vulen e saj dhe te figuroje ne te gjitha aktet ose dokumentat e nxjera nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve .
Per mardheniet e saj me subjektet jashte teritorit te Shqiperise , shoqeria do mbaje te njejtin emertim me germen Latine.


NENI 2
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne Qytetin e Korces, L.12, Rruga Kristo Grabocka, Nr. 30, Korce, Shqiperi.
Shoqeria mund te krijojte dege e filjale ne rrethe te tjera te Shqiperise dhe jashte saj .

NENI 3

Shoqeria Tregetare “EnRel Hydro” SHPK eshte subjekt Juridik Shqiptar dhe veprimtarine e saj e bazon ne legjislacionin Shqiptar dhe kryesisht ne ligji 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “

Regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar ndodhur ne QKR behet sipas dispozitave te ligjit 9723 date 03.05.2007 , Per Qendren Kombetare te Regjistrimit .



NENI 4
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e veprimtarise te Shoqerise do te jete me afat te pacaktuar mbi 10 vjet. Kohezgjatja e cila nis ne momentin qe ajo regjistrohet ne Regjistrin Tregetar prane QKR.

NENI 5

Kapitali i shoqerise ka vleren 100.000 Lek leke, Numri i Pjeseve 100,00
Vlera nominale e nje aksioni eshte 1.000,00 Leke
Ndarja e Aksioneve midis ortakeve te shoqerise eshte

1- Ortaku Aurel Naumi ne masen 100 % .

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje shume me te vogel ne shumen minimale e parashikuar nga ligji e detyron shoqerine te plotesoje ate , perndryshe ajo do te shnderohet ne nje forme tjeter ose te priset . Kontributet e sherbimet nuk mund te shperblehen me pjese ne kapitalin themeltar .


NENI 6

Objekti kryesor i veprimtarise ekonomike dhe qellimi i shoqerise:

- Ndertimi, Operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Zerec 1 & Zerec 2, tek Autoriteti Kontraktues, ku perfshihet Financimi, Projektimi, Ndertimi, Venia ne Pune, Prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike ne zbatim te kontrates koncesionare.
- Importi dhe venia ne perdorim e turbinave per prodhimin e energjise te gjitha llojeve dhe pajisjeve qe lidhe me to.
- Importi dhe venia ne perdorim e makinerive, pajisjeve e materjaleve te para te nevojshme per prodhimin e energjise te gjitha llojeve.

NENI 7

Organet drejtuese te shoqerise jane :



1. Asambleja e pergjitheshme e perbere nga Ortaku i vetem i shoqerise
2. Administratori i shoqerise

NENI 8

Shoqeria Tregetare "EnRel Hydro" SHPK do te administrohet nga Aurel Naumi, i cili do te perfaqesoje shoqerine ne te gjithë veprimtarine e saj. Administratori emerohet per nje perudhe 5 vjecare me te drejte riprertitje mbas zgjedhjeve te asamblese.

Administratori mund te shkarkohet nga Asambleja me shumice te zakoneshme.

Administratori kryen veprimet e administrimit ne interes te shoqerise .

Te gjitha veprimet qe ata merrin duhet te jene ne pajtim me interesin e siper marrjes .

Administratoret jane perfaqesuesit ligjore te shoqerise ndaj te treteve .

Ata kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise , ne te gjitha rrethanat .

Akti i themelimit miratohet nga ortaku themelues .

Akti i themelimit ne fjale u redaktua ne 4 kopje me permbajtjen dhe vlere te njejte ligjore , ne gjuhen shqipe dhe u firmos pa verejtje nga ortaku themelues

ORTAKU THEMELUES

Aurel Naumi

